



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



1 Tërmeti tek Aruba / SMS nga Sky: Ahmetaj, ç'a thotë Derman? Ke folur...do fakte, projekte serioze



2 Protesta te kryeministria në ditën e 37-të: organizatorët thirrje SPAK: Hetoni librin 'Albanian Files'! Nis marshimi nëpër Tiranë



3 'Mos shikoni Nolzyn, atë e mbron shteti'- Protestuesja sulmon artistët: Janë plehra që fshihen!



4 Protesta/ Sallanji-Borishë: Nëse je me protestuesit, jep dorëheqjen! Je patericë e Ramës, në Kryesi fute ata që të bëjnë më shumë like



5 Përplasjet për aeroportin e Vlorës, Pascolli: Hiqen kufizimet për VIA-n, asnjë vendim gjyqësor nuk pengon më përfundimin e punimeve

Kronikë

Tiranë/ Grabitet me armë një bankë te stadiumi 'Selman Stërmasi'! Autori i ka marrë paratë nga duart punonjëses që po i depozitonte, u largua me skuter

Klientja kishte nxjerrë çantën me para që do t'i depozitonte te arka e bankës, autori është afruar dhe ia ka marrë nga dora dhe më pas është larguar, pa ia dhënë akoma punonjëses së arkës. Ajo ka deklaruar se ka pasur me vete 10 mijë paund që do t'i depozitonte.

Tiranë/ Grabitet me armë një bankë te stadiumi 'Selman Stërmasi'! Gr Report TV



Watch on

Sokol Dema 2 Qershor, 12:50 | Përditësimi: 2 Qershor, 14:52



Një bankë e nivelit të 2 pranë stadiumit 'Selman Stërmasi' është grabitur mesditën e sotme nga një person ende i paidentifikuar. Ky i fundit hyri në bankë i maskuar dhe nën kërcënimin e një arme, i ka marrë paratë nga duart një klienteje që sapo i depozitonte.

Sapo kishte nxjerrë çantën me para që do t'i depozitonte te arka e bankës, autori është afruar dhe ia ka marrë nga dora dhe më pas është larguar, pa ia dhënë akoma punonjëses së arkës. Nga dëshmia e saj në polici ka deklaruar se ka pasur me vete 10 mijë paund që do t'i depozitonte.

Ende nuk është e qartë shuma e grabitur ndërsa raportohet se autori është larguar nga vendi i ngjarjes me skuter ndërsa në kokë ka pasur një skafandër motori. Autori ka mbërritur pranë bankës me një skuter nga drejtimi i kryqëzimit të Komunës së Parisit. Pasi e ka lënë mjetin jashtë, ai ka hyrë menjëherë në ambientet e bankës. Pas marrjes së shumës së parave, është larguar nëpërmjet rrugës "Sulejman Delvina", ndërsa dyshohet se më pas ka braktisur skuterin në një garazh.

[Sh] .com LEXO EDHE: Aksidenti i minibusit në Durrës-Tiranë/ U rikthye mrekullisht në jetë, 8-vjeçarit i amputohet këmba prej lëndimeve të rënda! Familja apel për ndihmë

Sipas hetimeve paraprake, ai ka vijuar arratisjen në drejtim të zonës së Bllokut. Policia po vijon kontrollet për identifikimin dhe kapjen e autorit.

"Tiranë/Informacion paraprak Rreth orës 12:26, në rrugën "Gjin Bue Shpata", një shtetas i maskuar ka hyrë në ambientet e një banke dhe, dyshohet se në kërcënimin e një sendi në dukje armë, ka marrë një shumë parash. Menjëherë pas marrjes së njoftimit, janë ngritur pika kontrolli dhe janë orientuar të gjitha shërbimet policore, për identifikimin dhe kapjen e autorit. Grupi hetimor po punon për identifikimin e autorit dhe dokumentimin e rastit", thuhet në njoftimin e policisë.

K.B/Shqiptarja.com TAG: Tirane grabitje banke

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

[Sh] .com Sondazhi i ditës: Sipas jush, protesta te Kuvendi a ka qenë e dhunshme nga ana e protestuesve? 3 Korrik, 10:41 Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

- Muzetë e Francës nuk gjejnë qetësi! Pas Luvrit, grabitje bizhuterish edhe në Laliq, dëmi përllogaritet rreth 4 milionë euro 6 Korrik, 07:56
- Tubimi para Kryeministrit, protestuesja rilexon kërkesat drejtuar Qeverisë 5 Korrik, 21:45
- Ben Andoni: Është vonë... 5 Korrik, 19:49
- Frrrok Çupi: Edi Rama, ditëlindjen siç e meriton 5 Korrik, 15:15
- Përmbysja e minibusit të linjës Berat-Tiranë, nënë e bijë dërgohen në Greqi për t'u trajtuar! Familjarët hapin edhe GoFundMe për ndihmë 5 Korrik, 13:40
- Dosja 'Saspac'/ Beqaj kundërshton vijimin e paraburgimit: Po mbahem në burg pa fakte të reja konkrete 5 Korrik, 12:23
- FOTO/ Mesazhet në Telegram zbulojnë organizimin e dhunës te Komisariatit nr. 3: 'Ta përdorim turmën, t'i nxjerrim çunat' 5 Korrik, 11:02
- Gurë e xhama kudo, dritare e rënë në tokë dhe derë e shqyer! VIDEO nga brenda Komisaritatit nr.3 pas sulmit nga protestuesit me maska 5 Korrik, 10:00
- Sulmohet komisarati numër 3, protestuesit e maskuar thyejnë xhamat me shkopinj, shqyejnë edhe derën! Policia kundërpërgjigjet me ujë (VIDEO) 4 Korrik, 23:43
- Protesta kombëtare kthehet në 'paradë' simbolesh! Tortë betoni për Ramën, arkivol 'politik' e uniformë e burgu! Diaspora kërkon zgjedhje të lira, 'Kryendrituri': Kuvendi do dalë nga sheshi 4 Korrik, 19:09
- 'Punoni ose shporruni!' Braçe ndan videon e mbeturinave në Selitë: Policia Bashkiake bën sehir e luan me telefon në makinë 4 Korrik, 16:18
- Vapa 'pushton' Tiranën, mjekët: Kujdes temperaturat e larta! Qytetarët kërkojnë hije, punëtorët 'sfidojnë' të nxehtin 4 Korrik, 15:39

Botërori i Super Ofertave CMIMI MË I MIRË 15.999 -36% 24.999

HOROSKOPI

Lajmi i fundit Tepelena nga protesta: SPAK të deputetët e PS të largohen nga Rama 6 Korrik, 21:20

×

[Sh].com

Lajmi i fundit



Tepelena nga protesta: SPAK të veprojë mbi 'Albania Files', deputetët e PS të largohen nga Rama

6 Korrik, 21:20